

STATUT dhe AKT THEMELIMI i
SHOQËRISË me PËRGJEGJËSI të KUFIZUAR
Audere Semper

Sot, më dt. 04 Janar 2024, unë, themeluesi GIRANDO KOTI, me ID G80719018R, shtetas shqiptar, i datëlindjes 19.07.1968, lindur e banues në Gjirokastër, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim Nr. 027601404

Me vullnet të lirë e të sinqertë, si dhe me iniciativën e tij, mbështetur në: Ligjin 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i përditësuar), në Ligjin 131-2012 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", Ligjin 9723 "Për Regjistrimin e Biznesit" (i përditësuar), dhe në Kodin Civil në fuqi,

Vendosi

NENI 1 Themelimi, emri, ortaket themelues

Të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin **Audere Semper**, me ortak të vetëm z. GIRANDO KOTI, të sipërpërmendur.

NENI 2 Selia dhe adresa

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën:

Qyteti Libohovë, Rruga Libohova, Nd. 39, Hy. 1nk.

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është:

Auderes4@gmail.com

NENI 3 Aktiviteti dhe territori

Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj tregëtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë shtetit. Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve mund të krijohen ose anullohen (në rast se janë çelur), seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë shtetit. Njësítë e tjera të Shoqërisë si degë, apo përfaqësi dhe jashtë shtetit, krijohen kur një gjë të tillë e parashikon dhe legjislationi i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare dhe parimet e reciprocitetit tregëtar midis vendeve të ndryshme.

NENI 4 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 200.000 Lekë (dyqind mijë Lekë).

Ortaku themelues GIRANDO KOTI, zotëron 1 (një) kuote, me vlerë të përgjithshme prej 200.000 lekë (dyqind mijë Lekë), që përbën 100% të kapitalit themeltar.

Kapitali i Shoqërisë do të rritet krahas ecurisë së saj ekonomike, financiare si dhe vendimeve që do të marrin ortakët e saj, për ta rritur atë në të ardhmen.

Në rast vdekje të ortakut pasuria u kalon trashëgimtarëve të tij sipas Legjislativit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 5 Administrator i shoqerise

Asambleja e Pergjithshme emëron si Administrator të Shoqerise **Audere Semper**, për një periudhë 4 vjeçare, z. GIRANDO KOTI, me ID G80719018R, i datëlindjes 19.07.1968, banues në adresen: Rruga Veli Harshova, Nd. 7, Hy. 11, Ap. 13, 6002, Gjirokastër.

NENI 6 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet shtimit të pjesëve të kapitalit me anë të kontributeve në para, dhe kontributeve në natyrë, nëpërmjet emertimit të një eksperti të autorizuar për vleresimin e këtyre kontributeve në natyrë.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyroje një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendimin në të njejtat kushte që kërkohej për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 7 Transferimi i kuotave të kapitalit

Pjesët e Kapitalit Themeltar janë lirisht të transferueshme në shitje ose në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ortaket kanë të drejtë të transferojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht apo tërrësisht kontributet e tyre përfshi dhe fondet dhe kontributet e pjesëve të Kapitalit Themelor.

Transferimi duhet të jetë i vërtetuar me Akt Notarial dhe për një gjë të tillë Asambleja e Ortakeve duhet të marrë paraprakisht vendim me shkrim.

Shoqëria dhe të tretët duhet të respektojnë këto transferime sapo tju bëhen të ditura.

NENI 8 Aktiviteti tregtar

Shoqëria krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj në këto drejtime:

- Aktiviteti i agjentit dhe përfaqësuesit tregtar.
- Import - eksport. Tregti e artikujve industrial dhe elektronik.
- Shitje online e artikujve të numizmatikës
- Shërbime Financiare e Juridike.
- Tregti për pjesë këmbimi e autovetura. Aktiviteti i ndërmjetësimit.
- Kryerja e veprimtarive të tjera financiare në ndihmë të biznesit në përputhje me legjislacionin tregtar dhe financiar në Shqipëri.

NENI 9 Aktiviteti ekonomik

Shoqëria çel llogari bankare në Lekë dhe në valutë, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financier të aktivitetit të saj. Administratori dhe Ortakët e caktuar, depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në Bankat ku është çelur llogaria.

NENI 10 Organi vendimarres

Asambleja e Ortakut është Organi më i Larte Drejtues dhe Vendimarres i Shoqërisë. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a)-përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b)-ndryshimet e statutit;
- c)-emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç)-emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d)-përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në pikat 'c' dhe 'ç';
- dh)-mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e)-miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë)-zmadhimin dhe zgjedhimin e kapitalit;
- f)-pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g)-përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj)-riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h)-miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i)-çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambeja e Ortakëve mund t'ja delegojë kompetencat një ose më shumë Administratori të caktuar prej saj, ose një personi fizik ose juridik jashtë ortakëris së Shoqërisë, gjithnjë vetëm mbi bazën e prokurës përball Noterit.

Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit.

NENI 11 Zgjerimi i aktivitetit

Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, Shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregëtar dhe në drejtime të tjera të cilat janë me interes për mbarëvajtjen fitimprurese të shoqërisë.

Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, Shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë Ortakë të tjerë, shtetas shqiptar apo të huaj, ose të bashkohet me një Shoqëri tjetër tregëtare si brenda, ashtu dhe jashtë shtetit.

NENI 12 Riorganizimi i shoqerise, baza ligjore

Shoqeria mund të ndahet ose bashkohet sipas Vendimit të Ortakëve, në përputhje me dispozitat e parashikuara ne Ligjin 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregate" pjesa IX.

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj ekonomik në perputhje me statutin e saj, dhe dispozitat ligjore në Republikën e Shqipërisë.

Për sa nuk parashikohet shprehimisht në këtë Statut/Akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e Ligjin 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodi Civil, dhe aktet e tjera ligjore specifike në Republikën e Shqipërisë.

Shoqëria fiton personalitetin juridik të saj vetëm pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dhe paisjen e saj me NIPT.

NENI 13 Mosmarreveshjet

Mosmarrëveshjet që mund të lindin brenda Shoqërisë, si dhe në marrëdhënie me personat e tretë jashtë, si dhe për çdo mosmarreveshje tjetër, do të jetë kompetente Gjykata e Shkalles së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Tiranë.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut Themelues

Gjana D. Kolli

